

# 30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE




Fq. 2

**AMA thirrje OSHMA-ve: Ndalni abuzimin me reklamat dhe komunikimet tregtare për barnat dhe trajtimet mjekësore**

**Forcimi i kapaciteteve, stafi i i AMA-s trajnim dy ditor me ekspertin e AGCOM-it**



Fq. 2



Fq. 2

**Dezinformimi në kohë lufte dhe konfliktesh, AMA mbështet Qendrën “Faktoje”**


AMA mbështet Qendrën “Faktoje” në organizimin e një programi trajnimi ...

**Pirateria gjobë 5 milionë lekë subjektit në Kukës**

Inspektorët e AMA-s kanë evidentuar një tjetër shkelës ligji i cili transmetonte në mënyrë pirate programet e dy platformave...



Fq. 2




Fq. 2

**Mediat Audiovizive, më shumë vëmendje lajmeve sociale**

Muaji janar ka prodhuar më shumë lajme sociale për mediat audiovizive. Sipas të dhënave të përlogaritura nga...

# Forcimi i kapaciteteve, stafi i i AMA-s trajnim dy ditor me ekspertin e AGCOM-it



Rregullimi i platformave të shpërndarjes së videove dhe masat për mbrojtjen e publikut, e në mënyrë të veçantë fëmijëve, ishin temat kryesore të trajnimit të stafit të AMA-s nga zyrtar i lartë i rregullatorit italian AGCOM, Z.Francesco Di Giorgi. Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela

Krasniqi u shpreh se ky trajnim është i nevojshëm, pasi rregullimi i platformave të shpërndarjes së videove është një detyrë që ligji ka ngarkuar Autoritetit për ta kryer. [Lexo më shumë](#)




## AMA thirrje OSHMA-ve: Ndalni abuzimin me reklamat dhe komunikimet tregtare për barnat dhe trajtimet mjekësore

OSHMA-të të ndalin abuzimin me reklamat dhe komunikimet tregtare për barnat dhe trajtimet mjekësore. Ky është ultimatumi i AMA-s drejtuar subjekteve audiovizive, të cilat përpiqen që hapësirën e shëndetit ta kthejnë në biznes. Pas verifikimeve, AMA i ka kërkuar OSHMA-ve ndërprerjen menjëhershme të këtyre praktikave antiligjore. [Lexo më shumë](#)



## Pirateria gjobë 5 milionë lekë subjektit në Kukës




## Dezinfomimi në kohë lufte dhe konfliktesh, AMA mbështet Qendrën “Faktoje”

AMA mbështet Qendrën “Faktoje” në organizimin e një programi trajnimi për gazetarët mbi “Dezinfomimin në kohë lufte dhe konfliktesh”. Kryetarja e AMA-s, Armela Krasniqi, theksoi rëndësinë e ndërgjegjësimit publik dhe profesionalizmit në raportim, veçanërisht në situata konflikti.

[Lexo më shumë](#)

Inspektorët e AMA-s kanë evidentuar një tjetër shkelës ligji i cili transmetonte në mënyrë pirate programet e dy platformave të licencuara. Ndaj këtij shkelësi është marrë masë administrative, sipas dispozitës ligjore ne fuqi, me gjobë 5 milionë lekë. Ndërkaq një tjetër rast piraterie është referuar në AKEP.

[Lexo më shumë](#)



## Mediat Audiovizive, më shumë vëmendje lajmeve sociale

Muaji janar ka prodhuar më shumë lajme sociale për mediat audiovizive. Sipas të dhënave të përlllogaritura nga ekipet e monitorimit dhe analizës në AMA pas sociale me 16.98%, vijnë lajmet ndërkombëtare me 14.82%, të ndjekura nga ato politike.

[Lexo më shumë](#)

